

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI I HISTORISË

KLASA VI

Tiranë, 2005

“QYTETËRIMET E HERSHME DHE MESJETARE BOTËRORE”
(Lashtësi –shek.XV)

HYRJE

Programi i lëndës “ Qytetërimet e hershme dhe mesjetare botërore” , përfshin studimin e zhvillimeve më të rëndësishme të historisë së lashtë dhe të mesjetës botërore gjatë këtyre dy epokave të rëndësishme historike.

Krahasuar me paraardhësin, ky program pasqyron përmirësime të rëndësishme në përmbajtje dhe strukturë. Disa prej tyre janë :

- Vendosja e një raporti më të drejtë ndërmjet aspekteve të zhvillimeve politike, diplomatike, ushtarake, nga njera anë, dhe ekonomike, kulturore e sociale, nga ana tjetër.
- Përfshirjes në studim të një numri më të madh të vendeve dhe popujve të cilët me zhvillimin e tyre të gjithanshëm ndikojnë në kuptimin më të mirë të epokave historike të lartpërmendura.
- Pasqyrimi i njohurive, shprehive dhe vlerave edukative, në formën e objektivave kryesorë që duhet të përvetsojnë nxënësit në përfundim të studimit të lëndës, e ndihmojnë mësuesin për një vlersim sa më objektiv të arritjeve.

Në program pasqyrohen arritje të reja shkencore për periudhat historike të lashtësisë dhe të mesjetës botërore.

OBJEKTI I STUDIMIT TË LËNDËS

Objekti i studimit të lëndës është njeriu dhe shoqëria njerëzore gjatë periudhave të lartpërmendura në të gjitha përmasat e saj: civile, ekonomike, sociale, politike dhe fetare.

OBJEKTIVAT KRYESORË TE PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Në përfundim të klasës VI nxënësit duhet të :

Kronologji

- Përdorin fjalë apo fraza që përcaktojnë periudha të ndryshme kohore brenda kufijve të përfshirë në studim, si : para lindjes së Krishtit, pas lindjes së Krishtit, kulturë e hershme, civilizim, legjendë, skllav, bujkrob, kryqëzatë, Magna Carta etj.
- Krijojnë linjën e kohës ku ngjarjet dhe periudhat historike të studiuara të vendosen sipas rendit kronologjik.

Gjerësia dhe thellësia e njohurive historike

- Njohin qytetërimet e hershme kryesore të përfshira në program.
- Njohin disa nga ngjarjet e rëndësishme që ndodhën gjatë periudhës mesjetare (kryqëzatat etj.).
- Demonstrtojnë se kanë kuptuar karakteristikat bazë të qytetërimeve të hershme.
Kuptojnë natyrën e qeverisjeve (të demokracive e të aristokracive) dhe përbërjen klasore të qytetërimeve të hershme.
- Njohin disa nga arritjet shkencore dhe teknologjike më të rëndësishme të qytetërimeve të hershme (arkitekturë, skulpturë, mjekësi etj.).
- Njohin dhe të krahasojnë tiparet dalluese ndërmjet qytetërimeve të hershme (struktura klasore, vendndodhja, qeverisja etj.).

- Njohin dhe përshkruajnë rolet e ndryshme të njerëzve në shoqërinë mesjetare (fshatarët, mbreti, klerikët etj.).
- Përshkruajnë ndikimin e kristianizmit dhe të kulturës islame në shoqërinë mesjetare.
- Analizojnë dhe interpretojnë informacionin për strukturën sociale, politike dhe ekonomike të shoqërisë mesjetare.

Interpretimi historik

- Analizojnë dhe vlerësojnë interpretimet e ndryshme të bëra për ngjarje, figura, situata dhe ndryshime me pasoja të rëndësishme për shoqëritë e përfshira në program.
- Jenë të hapur ndaj pikëpamjeve të ndryshme të shfaqura ndaj zhvillimeve historike të periudhave të caktuara duke debatuar mbi bazën e argumenteve shkencore.

Kërkime historike

- Bëjnë pyetje për të mbledhur informacionin e duhur rreth qytetërimeve të hershme dhe mesjetare.
- Zbulojnë informacione të rëndësishme për periudhat e përfshira në program nga burime të ndryshme historike (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.).

Organizimi dhe komunikimi

- Dijnë të përzgjedhin dhe të rendisin në mënyrë logjike informacionin historik për vendet dhe periudhat e studiuara, përfshirë të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme.
- Komunikojnë informacionin për çështje të ndryshme të shoqërive të hershme dhe mesjetare nëpërmjet paraqitjes gojore, hartave, grafikëve etj.

PROGRAMI SINTETIK

35 javë x 2 orë në javë	70 orë vjetore
Njohuri të reja	61 orë
Përsëritje dhe orë në dispozicion	9 orë
Gjithsej	70 orë

PROGRAMI ANALITIK HISTORIA E LASHTË

KREU I PARAHISTORIA	(4 orë)
KREU II QYTETËRIMET E LUMENJVE (mijëvjeçari IV-III para l. Krishtit)	(4 orë)
KREU III BANORËT E LASHTË TË BALLKANIT	(1orë)

KREU IV	
LINDJA E QYTETËRIMEVE TË REJA (mijëvjeçari III para l. krishtit)	(4 orë)
KREU V	
GREQIA E VJETËR	(7 orë)
KREU VI	
MAQEDONIA E LASHTË	(2 orë)
KREU VII	
ROMA E VJETËR	(6 orë)
KREU VIII	
ILIRËT	(4 orë)
HISTORIA E MESJETËS	
KREU IX	
MESJETA E HERSHME (SHEKUJT V - X)	(9 orë)
KREU X	
ORGANIZIMI SHOQËROR NË MESJETË	(5 orë)
KREU XI	
KRIJIMI I MONARKIVE KOMBËTARE NË EVROPË (SHEKUJT XI - XV)	(5 orë)
KREU XII	
PERANDORITË E MËDHA TË LINDJES	(2 orë)
KREU XIII	
ARBËRIA NË SHEKUJT XI – XV	(3 orë)
KREU XIV	
HUMANIZMI DHE RILINDJA EVROPIANE (SHEKUJT XIV – XV)	(5 orë)

METODAT E TË MËSUARIT

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje më veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës të parashikuar nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren: shpjegimi, mësimi zbulues, diskutimi që zgjidh problemin, brainstorming, biseda etj.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe të teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si : harta historike të përgjithshme apo tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta etj.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i nxënësve mund të jetë sistematik (për çdo temë mësimore), periodik (në përfundim të çdo kapitulli), semestral dhe vjetor.

Ai mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: me gojë (pjesërisht apo frontalisht), me shkrim, veprimtarisë praktike, testimit etj.

Gjatë realizimit të këtyre formave mbahen parasysh disa nga cilësitë më kryesore të tij, si: vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe përdorshmëria.

Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË HISTORISË PËR KLASËN E GJASHTË

Përveç kërkesave që parashtrihen në programin zyrtar të lëndës së historisë për klasën e gjashtë të ciklit të mesëm të ulët, puna e institucioneve dhe e grupeve të autorëve që do të marrin përsipër hartimin e tekstit, të përqendrohet edhe në plotësimin e disa kriterëve të tjera që kanë të bëjnë si me këndvështrime të përgjithshme, edhe me këndvështrimë të veçanta shkencore e didaktike, të cilat paraqiten në vijim.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë instrumenti me frytshmëri i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet konceptuale, edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- ◆ Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe në veçanti me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- ◆ Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- ◆ Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- ◆ Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- ◆ Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit në lëndën e historisë;
- ◆ Të synojë realizimin e një dokumenti të përshtatshëm, që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, edhe nga ana metodike.

II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË HISTORISË

Teksti i lëndës së historisë, synon ndër të tjera të krijojë në klasë, në miniaturë, një mjedis historik të cilin nxënësit duhet ta përjetojnë. Ai duhet të krijojë mundësinë jo vetëm të bashkëpunimit krijues të nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, madje më gjerë, bashkëpunimin e mjedisit shkollor me mjedisin jashtë shkollës.

Teksti i lëndës së historisë-6 të jetë në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH. Ai të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti t'u pëmbahet qëllimeve të sistemit arsimor në përgjithësi dhe të programit në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:

1. të qëllimeve të shprehura hapur në program. Kjo do të thotë që në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari që synojnë të arrihet qëllimi i shprehur në program;
2. qëllimeve të nënkuptuara. Kjo do të thotë që autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

Teksti nuk është përkthim i programit, i cili ka karakter sa detyrues, aq edhe udhëzues. Prandaj autorët ta mbajnë parasysh atë. Këta të fundit duke patur një

konceptim të qartë të procesit mësimor dhe duke patur perceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor përmirësimi në mësimdhënien e lëndës së historisë. Në këtë drejtim autorët mund të shfrytëzojnë:

- ◆ Hapësirat dhe fleksibilitetin e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet);
- ◆ Aparatin pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

Teksti të japë mundësi, të sjellë në klasë shembuj konkretë nga periudha historike e përfshirë në studim.

Nga pikëpamja pedagogjike, teksti të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve.

Kjo do të thotë që teksti të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit,, krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm. Këtu të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga njohuritë historike. Për këtë arsye autori (autorët) e tekstit të parashikojë ato njohuri që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

Sistemi i pyetjeve në fund të njësive mësimore (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera), të ofrojë mundësinë që nxënësit:

- Në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
 - Të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësive mësimore dhe të objektivave të programit;
 - Të krijojë mendimin dhe qëndrimet e tij të pavarura, të mbështetura me argumente, por të pranojë, të respektojë dhe të marrë parasysh argumentet e të tjerëve;
- Mësuesit :
- Të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së historisë;
 - Të planifikojnë më mirë orën mësimore;
 - Të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
 - Të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
 - Të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuara gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe shprehive të reja;
 - Të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj
- ◆ Teksti të përmbajë mësimet ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qarta mësimore në përputhje me programin e rekomanduar ose me standardet lëndore.
 - ◆ Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (atlasë, harta, foto dhe albume historike etj.), gjë që do të bënte tekstin ose njësinë mësimore më fleksibël dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur individuale, kërkimore të nxënësve.
 - ◆ Gjuha e teksteve duhet të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.

- ◆ Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato duhet të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësisë mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
- ◆ Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve duhet të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpeshherë krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë informacionin kryesor nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore.
- ◆ Autorët duhet të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit në kushtet e kufizimit sasior(informacionit) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shtesë (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikë, etj) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
- ◆ Njësia mësimore e tekstit duhet të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e funksioneve të tekstit si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtësore të temave të veçanta.
- ◆ Struktura e ndarjeve të tekstit si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (psh, temës) duhet të jenë uniforme gjatë gjithë tekstit.
- ◆ Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (titujve, teksteve, figurave, pyetësorit, detyrave, ushtrimeve ritmikë dhe melodikë, etj) duhet të jetë tërheqës dhe i mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës në përgjithësi dhe temës në veçanti.
- ◆ Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, qartësimeve, ngjyrave etj, duhet të jetë i balancuar dhe në funksion të çështjes që trajtohet.